



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:071933
Datë: 25.06.2024
Numri i dokumentit: 05854218

PPP.nr.85/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i përgjithshëm, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit B.E. sh.a, me seli në Prishtinë, "...", kundër debitorit O.H. nga Ferizaj, rr "...", nr.48, për lirimin e paluajtshmërisë, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 25.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit O.H., i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.137/22, të datës 31.03.2022, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat B.T. nga Ferizaj dhe **MBETET NË FUQI** urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.137/22, i datës 31.03.2022.

A r s y e t i m

Me urdhrin për përmbarim P.nr.137/22, të datës 31.03.2022, Përmbaruesi privat B.T. e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga kreditori B.E. sh.a, kundër debitorit O.H., për përmbarimin e urdhrin P.nr.73/18, të datës 17.12.2018, për detyrimin e debitorit, për dorëzimin e paluajtshmërisë kreditorit, nr.P-..., ZK ..., si dhe pagesën e shpenzimeve të përmbarimit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, me të cilin i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin për përmbarim.

Kreditori, në përgjigjen e ushtruar me shkrim, në prapësimin e debitorit, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi në fjalë është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim i lëshuar nga Përmbaruesi privat B.T., me numër P.nr.137/22, i datës 31.03.2022, është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore ngase përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.1, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se duke u bazuar në ngjarjet, përkatësisht problemet që i kanë paraprirë debitorit me sëmundje të anëtarëve të familjes, gjendjen e pandemisë, humbjen e vendit të punës, orvatjet dhe përpjekjet për krijimin e marrëdhënies së punës e të tjera probleme, e kanë sjellë debitorin në gjendjen ligjore që tani është, gjykata këtë pretendim e konsideron të pabazuar sepse i njëjti duke e marrë parasysh gjendjen e tij financiare, në bazë të nenit 61, të LPP-së, ka të drejtë që të kërkoj nga organi përmbarues, shtyrjen e përmbarimit deri në një afat prej gjashtë muaj.

Gjithashtu, sa i përket pretendimit të debitorit se në të gjitha fazat e procedurës ka kërkuar një pasqyrë të borxhit të mbetur dhe atë të paguar duke mos e mohuar faktin që ka borxhin ndaj kreditorit por pa marr asnjë informacion nga kreditori lidhur me kërkesën e tij për ecurinë e pagesave, përkatësisht borxhit të papaguar nga debitori, gjithashtu debitori ka shprehur vullnetin për pagimin e borxhit sipas mundësive që kishte nëpër kohë të ndryshme por një gjë e tillë nuk është aprovuar nga kreditori, gjykata edhe këtë pretendim e konsideron të pabazuar sepse në rastin konkret gjykata nuk ka për objekt shqyrtimi shumën e borxhit që debitori mund të i ketë kreditorit por vlerësimin e ligjshmërisë së urdhrin për përmbarim i cili në këtë rast është nxjerrë në bazë të urdhrin P.nr.73/18, të datës 17.12.2018, me të cilin është

detyruar debitori O.H. që paluajtshmërinë me numër P-..., ZK ..., t'ia dorëzoj kreditorit, por jo edhe në bazë të kontratës mbi hipotekës. Për më tepër, gjykata konstaton se urdhri P.nr.73/18, i datës 17.12.2018, konsiderohet dokument përmbartimor në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.9, të LPP-së, i cili e përmban klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri, e paraparë në nenin 36, par 1, të LPP-së, respektivisht urdhri është i formës së prerë nga data 02.04.2021.

Gjykata, po ashtu konstaton se i autorizuari i kreditorit bashkë me propozimin për përmbartim, tek përmbartuesi privat e ka dorëzuar edhe urdhrin P.nr.73/18, të datës 17.12.2018, në kopje të vërtetuar.

Përveç tjerash, gjykata konstaton se urdhri i cekur më lart është në tërësi i përshtatshëm për përmbartim dhe në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, pasi që në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartshjes se detyrimit, siç është afati prej 7 ditësh.

Andaj, Gjykata duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, përgjigjen me shkrim të kreditorit në prapësimin e debitorit, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa urdhri për përmbartim P.nr.137/22, i datës 31.03.2022, të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.85/22, më datë 25.06.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.